



## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/62

Data: 20.02.2023

PODUJEVË

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, nenin 35 paragrafi 1, 4, 5 dhe 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenin 5 pika c të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, dhe nenin 8 pika 6 të Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.05/2021 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës shpall këtë:

## KONKURS

### PËR ASISTENT/E PËR FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA

**Titulli i vendit të punës:** Asistent/e për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e Komunës së Podujevës

**Numri i pozitave:** 3 (tri)

**Orari i punës:** 30+10 ( orë në javë)

**Paga bazë:** 397.01 Euro

**Kohëzgjatja e kontratës:** deri më 31.08.2023

**Data e njoftimit:** 20/02/2023 - 21.03.2023 (<https://konkursi.rks-gov.net>)

**Afati për aplikim:** 22/03/2023 - 05/04/2023

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ndhmon fëmijët/ nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër së zbatimit e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatitë informatat kthyesë për vështirësitë dhe arritjen e fëmijëve;
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/ nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike/ personale, mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësuesin/ mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim;
- Promovon bashkëpunim shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;



- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve;
- Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale.

**Kushtet:** Niveli i 5-të (postsekondar) PEARSON i kualifikimit asistent/e për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

**VËREJTJE:** Sipas Udhëzimit Administrativ (MASHTI) NR.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 8 paragrafi 6, pika 6.1, “Të gjithë kandidatët e kualifikuar në nivelin e 5-të (post sekondar) të kualifikimit për asistent, për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” i plotësojnë kriteret për punësim”.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve);
- Rezyrmeja personale (CV);
- Diploma mbi përgatitjen profesionale, kualifikimi i nivelit të pestë (5) post-sekondar (kopja e vërtetuar);
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës (nëse ka);
- Çertifikata e lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime.

**Mënyra e aplikimit**

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

*Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.*

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të informohen përmes njoftimimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës, pas mbylljes së konkursit.

**Sqarim:**

Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

**Avni Fetahu**

Drejtor i DKA-së

